


PLATFORMË

**QEVERISJE LOKALE
QË GARANTON
BARAZI GJINORE**

Prizren - 2017



2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Barazia gjinore nuk është vetëm e drejtë njerëzore, por është një domosdoshmëri për zhvillim dhe integrim të një shteti.

Diskriminimi në baza gjinore trajtohet me *nenin 1* të Ligjit për Barazinë Gjinore. Për më tepër, obligohet trajtimi i barabartë - pa diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë bazuar në gjini, si dhe promovimi i barazisë gjinore. Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës parasheh 50% të përfshirjes së dy gjinive (neni 5,6 dhe 14). Më saktësisht, në nenin 6 të këtij ligji thuhet se: *“Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësimi minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet tjera drejtuese dhe vendimmarrëse” (neni 6, alinea 8).*

Poashtu, avokati i popullit që nga zgjedhjet e fundit parlamentare ka bërë thirrje publike që subjektet politike t’i zbatojnë kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore, por nuk është marrë parasysht kjo thirrje, me ç’rast subjektet politike e kanë shtyrë vetëm idenë e përfaqësimit me 30% të grave në lista zgjedhore dhe jo ashtu siç e parasheh ligji në fjalë.

Në një hulumtim të realizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore citohet se konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave e quajtur “CEDAW”, është pjesë integrale e Kushtetutës së Kosovës (e inkorporuar në Kushtetutën tonë), përkatësisht *neni 22- pika 6*. Qëllimi i “CEDAW” është eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe të arrihen liritë dhe të drejtat e plota për gratë baraz me burrat. Konventa rikujton se diskriminimi kundër grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe respektit për dinjitetin njerëzor, gjithashtu është pengesë për pjesëmarrjen e grave në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore.

Ligji i Punës i Republikës së Kosovës, me theks të veçantë *neni 5* i këtij ligji ndalon të gjitha format e diskriminimit në vendin e punës dhe në profesion. Gjithashtu, rol të rëndësishëm në legjislacionin tonë të brendshëm mbi parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të diskriminimit, duke përfshirë edhe diskriminimin në baza gjinore, ka edhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Për respektimin, zbatimin dhe implementimin e ligjeve në fuqi sa i përket integritetit të barazisë gjinore, duhet vullnet dhe bashkëpunim shoqëror në mënyrë që të përmbushen interesat e përgjithshme të dy gjinive. Kjo praktikë duhet të ndodhë pasi që kushtetuta dhe ligjet në fuqi garantojnë trajtim të barabartë mes gjinive, por këto nuk respektohen dhe nuk ka zbatim në praktikë, andaj bashkëpunimi kërkohet me ç'do kusht. Barazia gjinore është kërkesë e cila rrjedh nga kushtetuta, si pjesë e trajtimit të barabartë para ligjit pa asnjë dallim.

3. PËRFAQËSIMI I GRAVE NË EKZEKUTIV

Praktikat e qeverisjes së kaluar në Komunën e Prizrenit (2013-2017) nuk kanë lënë një pasqyrë të mirë në përfaqësimin e grave në dikasteret e saj, duke i emëruar kështu vetëm dy (2) gra në udhëheqje nga gjithsej njëmbëdhjetë (11) drejtori, drejtori të cilat edhe mund të mendohet që kanë qenë më shumë stereotipike se sa meritore. E njëjta ndodh edhe në përfaqësimin e grave në komitete të ndryshme, ku shihet të ketë fare pak përfaqësim të grave dhe me këtë fakt kuptohet se ato sa më pak që janë të përfaqësuara në dikastere të rëndësishme, aq më pak e kanë mundësi t'i adresojnë dhe të marrin zgjidhje për problemet me të cilat ballafaqohen në lagjen apo komunën e tyre.

Për përmirësimin e këtij fenomeni të krijuar, së pari partitë politike duhet të jenë të vetëdijshme në krijimin e hapësirës brenda subjektit politik për gratë, fillesa e vendimmarrjes së grave në ekzekutiv është nga subjekti politik në mënyrë që ato më tutje të delegohen në ekzekutiv dhe pozita vendimmarrëse.

Një praktikë e tillë po shihet se do të vazhdojë edhe në përbërjen e qeverisjes së re. Edhe pse barazia gjinore përmendet gjithandej gjatë fushatave të kandidatëve për kryetarë, këtë e demanton fakti i përmbajtjes së platformave të kandidatëve për kryetarë komune ku pothuajse në asnjë prioritet nuk e kanë të integruar komponentën e barazisë gjinore, apo thënë më mirë shumë pak dhe rrallë përmendet si politikë me rëndësi për një trajtim të mirëfilltë gjatë mandatit, të cilin pretendojnë ta marrin. Subjekti politik duhet të sigurohen që në programet e tyre të jenë më të kujdesshme nga aspekti gjinor, të sigurojnë se ato programe përmbajnë barazi në trajtimin e çështjeve me tutje në mandatin e tyre.

Për një përfaqësim të barabartë Komuna e Prizrenit duhet ta ndërmarrë iniciativa të cilat do t'i involvonin edhe gratë e shoqërisë civile, gjithashtu edhe aktivistet në konsultimet/bisedimet e temave të cilat komuna i trajton për gratë. Një praktikë e tillë kishte me dhënë hapësirë dhe transparencë pothuajse të plotë të involvimit të qytetarëve në hartimin e politikave me interes të qytetarëve, në këtë rast të grave.

|||||

Bashkëpunimi në mes ekzekutivit dhe shoqërisë civile duhet të jetë ndër prioritetet e udhëheqësve, në mënyrë që transparencja dhe gjithëpërfshirja të jetë në nivele të kënaqshme.

Ky bashkëpunim do të shpie edhe më lehtë në identifikimin e problemeve të të gjitha grave në komunë, duke promovuar kështu rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje barabartë me burrat si dhe pjesëmarrjen e tyre politike dhe publike në përgjithësi.

Qeverisja e ardhshme duhet të ketë së paku 50% të drejtorive të udhëhequra nga gratë, të nominuara dhe emëruara nga ekzekutivi në baza meritore dhe konform ligjit në fuqi. Gratë duhet të përkrahen nga subjekti politik, pra duhet të shtohet vullneti i subjekteve politike në mënyrë që gratë të jenë të përfaqësuara në baza meritore. Kur gratë janë të përfaqësuara aq sa duhet, ato nuk do ta shohin vehten të anashkaluar padrejtësisht dhe të mos-involvuar në të gjitha politikat lokale me rëndësi, politika këto të cilat janë të gjithë qytetarëve dhe jo vetëm të burrave, ashtu siç perceptohen.

Objektivat që duhet të arrihen në kuadër të trajtimit të kësaj çështje janë:

- Nominimi 50% i grave në ekzekutiv për poste vendimmarrëse;
- Përfshirja e grave dhe vazhata të shoqërisë civile në hartimin e politikave me rëndësi për to.

|||||

4. PËRFAQËSIMI I GRAVE NË MEDIA

Sipas shumë hulumtimeve televizioni mbetet burimi kryesor i informacionit, por gjithashtu rolin gati më kryesor me kalimin e kohës e ka zëvendësuar përdorimi i internetit dhe mediave sociale, duke lënë në këtë rast mediat e shkruara (shtypin) shumë më anash sepse nuk mendohet se paraqesin burimin kryesor të lajmit.

Por, mbi gjitha këto të dhëna dhe mundësi të paraqitjeve publike, ende trendi i numrit të ulët të grave në media vazhdon të jetë problematikë në vete në tërë Kosovën, gjithashtu edhe në komunën e Prizrenit.

Sa i përket paraqitjes mediale të grave, një praktikë dhe një përmirësim nuk po shihet që tani, gjatë fushatës parazgjedhore. Edhe pse duhet marrë parasysh se mediat lokale kanë më pak emisione televizive për diskutime të ndryshme, megjithatë duhet të merret parasysh se në ato emisione duhet të kenë hapësirë të barabartë si burrat poashtu edhe gratë.

Qeverisja e ardhshme lokale duhet të ketë fokus të veçantë në atë se gratë duhet ftohen dhe delegohen së pari nga subjekti politik dhe së dyti nga ekzekutivi, pastaj në paraqitje mediale në të gjitha temat e diskutimit/debatit, pa i ndarë ato të burrave dhe të grave.

Bashkë me qeverisjen, gjithashtu edhe programet televizive të ndryshme në media duhet ta kenë hapësirën edhe për gratë, duke i ftuar ato në debate, intervista dhe kronika të ndryshme. Konform kësaj të jetë në nivel edhe gjuha publike që përdoret në këto emisione televizive, pasi që jo rrallë herë nga praktika kemi përvojë të sulmit të grave në media me fjalë fyese.

Dihet se gratë jo vetëm në komunën e Prizrenit, por në tërë Kosovën janë jashtëzakonisht pak të paraqitura në media, kjo për arsye se gratë nuk përkrahen dhe delegohen aq sa duhet nga shoqëria përreth, pastaj nga vendi i punës apo edhe nga subjekti politik që ato përfaqësojnë. Grave ende nuk u

|||||

besohet diskutimi dhe debati për tema të cilat kanë aktualitet në vend dhe numërohen si madhore dhe të rëndësishme.

Një tjetër mendim që adresohet nga vet gratë, sa i përket paraqitjes mediale, është edhe vullneti i vogël nga vet gratë për tu paraqitur, kjo e cila ndodh në shumicën e rasteve për shkak të gjuhës fyese që përdoret ndaj tyre në media si dhe mos-involvimin e tyre në çështje me rëndësi në komunën e tyre, por vetëm hapësira për diskutime me tema stereotipike gjinore.

Sipas një hulumtimi të zhvilluar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM) në vitin 2013, me këtë rast nga monitorimi i tri kanaleve televizive RTK, KTV dhe RTV 21, del se përfaqësimi i grave në media ka qenë shumë i ulët, duke dhënë kështu këto rezultate: RTK ka dhënë hapësirë për gra me 5,21 %, KTV me 7,72% dhe RTV21 me vetëm 4,20 %.

|||||

POLITIKA REKOMANDUESE:

- 1) *Trajtim i barabartë i të dy gjinive brenda ekzekutivit;*
- 2) *Hapa konkret në funksionimin e zyreve/departamenteve ekzekutive të barazisë gjinore;*
- 3) *Vlerësim meritior në pozita vendimmarrëse dhe vende të punës si dhe luftimi i qasjes dhe politikave selektive;*
- 4) *Masa parandaluese dhe dënuese të gjuhës diskriminuese ndaj grave;*
- 5) *Të zhvillohen politika specifike nga ana e komunës në subvencionimin e vetiniciativave biznesore të grave dhe përkrahja e tyre në tregun e punës në përgjithësi;*
- 6) *Mbështetja e grave me kushte të rënda ekonomike, specifikisht në kujdesin shëndetësor primar si dhe ofrimi i kushteve dhe kujdesit gjatë lindjes së fëmijëve;*
- 7) *Kujdes i shtuar nga ana e organeve të rendit sa i përket sigurisë publike të grave;*
- 8) *Politika konkrete dhe kod të veçantë të buxhetit për nënat vetushqyese;*
- 9) *Përkrahje financiare strehimores së grave në Prizen;*
- 10) *Konkurset e punës të publikohen në mënyrë transparente në faqen zyrtare të komunës si dhe të mënjanojnë politikat diskriminuese ndaj grave në ato konkurse.*

This publication is part of the project "United women for a gender friendly political, economic and social governance", implemented by (KDI, Ec ma Ndryshe and FEMaktiv, financed by Olof Palme International Center supported by Swedish Government. Content of this publication reflects author's opinions and not necessarily Olof Palme International Center opinions.

